- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

### **Neni 30 Shkaqet për kompensim**

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

### **PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET**

#### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

#### **Neni 32 Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

#### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

#### **Neni 35 Pranimit përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

### **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

#### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39           Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40           Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41           Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42           Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43           Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 624-24-7542-5-2-1/C1239

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	<b>Ndërtimi i sallës sportive në SHFMU Vëllëzrit Frashëri - Bukosh - RITENDER</b>  me numër identifikues: 624-24-7542-5-2-1 & 624-24-08-521
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe.</b>
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <b>30,195.57 euro 10% e vlerës së kontratës për një periudhë prej 13 muajve</b>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i

		pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 dite pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit të gjitha Punëve do të jetë mbrenda 12 muajve.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim të ZKA-së.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës.  Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK.  Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".  Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve (shëno nr. e viteve të periudhës garantuase)
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuase e defekteve është 7 vite sipas garancionit të punimeve të Aneksi 6.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë



<p>Zgjidhja mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore</p>	<p>c 43.1</p>	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>
---	-------------------	---

<b>Për:</b>	<b>ZYREN E PROKURIMIT KOMUNA SUHAREKË</b>
<b>Nga:</b>	"NBT -ING" SH.P.K., Brigada 123 p.n, SHIROKË, NUI 810636805
<b>Lënda:</b>	<b>DEKLERATË PER KUALITETIN E PUNIMEVE</b>
<b>Datë:</b>	<b>20.01.2025</b>

**I/e nderuar,**

**Ndërtimi i salles sportive ne SHFMU Vëllëzrit Frashëri - Bukosh - RITENDER**

me numër identifikues: 624-24-7542-5-2-1 & 624-24-08-521

Për të përmbushur obligimet që dalin nga neni 27 pika 1 dhe 34.5 (KVK) e kontratës së lartcekur.

Ne konfirmojmë se:

Ne si Operator Ekonomik pas pranimit përfundimtar të kryerjes se punëve ofrojmë garancion të rregullt 7 vjeçar, duke siguruar garancion prej 10 % nga vlera e kontratës, si dhe deklarojmë mbi cilësinë e punës dhe mallrave në kohëzgjatje 7 vjet nga dita e pranimit përfundimtar te kryerjes se punimeve dhe obligohemi dhe pranojmë se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do t'i sanojmë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim. Në të kundërtën ne pajtohemi se AK ato dëme do t'i sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do të na faturojë ne si Kontraktor që kemi dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve.

**Me respekt:**

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit : BEKHET BARIQARAJ Nënshkrimi

**Datë: 20.01.2025**





## PARAMASA PËR KRYERJEN E PUNËVE

Ndërtimi i objektit të ri të Sallës së Edukates Fizike në Bukosh - Komuna Suharekës

### 1. PUNËT NDËRTIMORE DHE ZEJTARE

1. PUNËT PREGATITORE-DEMOLUESE					
Poz.1	Përsëkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1.1	Rrethimi i truallit për ndërtimin e objektit dhe shënjëzimi informativë, lartësia e rrethojës duhet të jetë ~2.0m, shtyllat nga profile metalike si dhe rrethoja nga llamarina.	m'	200.00	1.00 €	200.00
1.3	Pozicionimi gjeodezik dhe shënjëzimi i objektit për ndërtim.	m <sup>2</sup>	696.50	2.00 €	1,393.00
1.4	Furnizimi me material dhe ndërtimi wc-se dhe vendosjes se kontinjerit.	komplet	1.00	100.00 €	100.00
1.5	Furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohëshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriqimit të kanjerit.	komplet	1.00	100.00 €	100.00
					€ 1,793.00

2. PUNËT EIDHEUT					
Poz.2	Përsëkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
2.1	Gërmimi i shtreses së humusit dhe largimi i dheut deri në deponi.	m <sup>3</sup>	250.74	3.00 €	752.22
2.2	Gërmimi i dheut të kategorise 3 dhe 4 për hapjen e themeleve të veqara të objektit dhe transportimi i dheut deri në deponi.	m <sup>3</sup>	89.50	3.00 €	268.50
2.3	Gërmimi i dheut të kategorise 3 dhe 4 për hapjen e themeleve shiritore të objektit dhe transportimi i dheut deri në deponi.	m <sup>3</sup>	170.50	3.00 €	511.50
2.3	Ngjeshja e dheut me mekanizem deri në arrijen e kompaktësise së nevojshme të dheut për ndërtimin e objektit, trotuareve dhe stazave për kembesore etj.	m <sup>2</sup>	831.60	3.00 €	2,494.80
2.5	Gërmimi i dheut të kategorise 3 dhe 4 për hapjen e trotuareve dhe shtigjeve për kembesore, largimi i dheut nga vendpunishja.	m <sup>3</sup>	75.25	3.00 €	225.75
					€ 4,252.77

3. PUNËT E ZHAVORIT					
Poz.3	Përsëkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
3.1	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtreses së zhavorit sipas fraksioneve të parapara me projekt (0-60mm dhe 0-30mm) në tabanin e themeleve si dhe nën pllaken e perdheses. Moduli i ngjeshjes 40MPa.	m <sup>3</sup>	256.63	8.00 €	2,053.00
3.2	Furnizimi me material si dhe mbushja dhe ngjeshja e "coklles" (hapësirat brenda themeleve shiritore) me material mbushës të sjellur nga gurthyesi (0-150mm).	m <sup>3</sup>	218.50	10.00 €	2,185.00
3.3	Furnizimi me materiale dhe vendosja e zhavorit në perimetër të mureve të jashtme për punimin e drenazhes (material adekuat për drenazhe).	m <sup>3</sup>	150.00	10.00 €	1,500.00
3.4	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtreses së zhavorit sipas fraksioneve të parapara me projekt (0-60mm dhe 0-30mm) për rrugët automobilistike, parkingjet, fushat sportive, stazat për ecje etj. Moduli i ngjeshjes 40MPa.	m <sup>3</sup>	45.50	10.00 €	455.00
					€ 6,193.00

4. PUNËT E BETONIT					
Poz.4	Përsëkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma

4.1	Furnizimi me material si dhe betonimi i shtreses rrafshuese nga betoni i paarmuar C-15/20 te pjeses nen themele te veqara,shiritore dhe pllaken e perdheses_niv ±0.00.Betonimi me trashesi 5-8cm.	m <sup>3</sup>	42.50	10.00	€	425.00	✓	
4.4	Furnizimi me material si dhe betonimi i themeleve te veqara dhe shpates se themeleve shiritore sipas projektit me beton C-25/30, me aditiv kristalor per arritjen e padepertuesmerise nga uji, ne masen 1 kg per cdo 100 kg te cimentos. Ne cmim te perfshihen te gjitha mjetet lidhese, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme per realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	63.50	110.00	€	6,985.00	✓	
4.5	Furnizimi me material si dhe betonimi me beton kualitativ C-25/30, te mureve mbi themele te veqara dhe alyre shiritore (cokulles) me dimensione sipas projektit, me aditiv kristalor per arritjen e padepertuesmerise nga uji, ne masen 1 kg per cdo 100 kg te cimentos. Ne cmim te perfshihen te gjitha mjetet lidhese, distancuesit dhe kallëpet e ne	m <sup>3</sup>	47.50	110.00	€	5,225.00	✓	
4.6	Furnizimi me material si dhe betonimi me beton kualitativ C-25/30, te pllakes se perdheses me dimensione sipas projektit, me aditiv kristalor per arritjen e padepertuesmerise nga uji, ne masen 1 kg per cdo 100 kg te cimentos. Ne cmim te perfshihen te gjitha mjetet lidhese, distancuesit dhe kallëpet e ne	m <sup>3</sup>	136.00	110.00	€	14,960.00	✓	
4.7	Furnizimi me material si dhe betonimi i shyllave dhe mureve te betonit ne lere objektin (elementet vertikale), te punohen sipas projektit, me beton C30/37, me aditiv kristalor per arritjen e padepertuesmerise nga uji, ne masen 1 kg per cdo 100 kg te cimentos. Ne cmim te perfshihen te gjitha mjetet lidhese, distancuesit dhe kallëpet e ne	m <sup>3</sup>	139.50	110.00	€	15,345.00	✓	
4.8	Furnizimi me material si dhe betonimi i rampave, shkalleve hyrese dhe pllatove, me beton C-25/30. Te punohen sipas projektit. Ne kete pozicion te parashihet edhe armimi, me aditiv kristalor per arritjen e padepertuesmerise nga uji, ne masen 1 kg per cdo 100 kg te cimentos. Ne cmim te perfshihen te gjitha mjetet lidhese, distancuesit dhe kallëpet e ne	m <sup>3</sup>	4.20	110.00	€	462.00	✓	
4.9	Furnizimi me material si dhe betonimi i traqeve ne tere objektin (elementet horizontale) te punohen sipas projektit, me beton C-25/30, me aditiv kristalor per arritjen e padepertuesmerise nga uji, ne masen 1 kg per cdo 100 kg te cimentos. Ne cmim te perfshihen te gjitha mjetet lidhese, distancuesit dhe kallëpet e ne	m <sup>3</sup>	51.50	110.00	€	5,665.00	✓	
4.11	Furnizimi me material si dhe betonimi i pllakes se meskatit ne pjesen e objektit (zhveshtoreve), te punohen sipas projektit, me beton C-25/30, me aditiv kristalor per arritjen e padepertuesmerise nga uji, ne masen 1 kg per cdo 100 kg te cimentos. Ne cmim te perfshihen te gjitha mjetet lidhese, distancuesit dhe kallëpet e ne	m <sup>3</sup>	32.00	110.00	€	3,520.00	✓	
4.13	Furnizimi me material si dhe betonimi i arkitrajeve mbi dyer e dritare me beton C-25/30, ne cmim te parashihet edhe armimi i ketij pozicioni.	m <sup>3</sup>	3.45	110.00	€	379.50	✓	
						€	52,986.50	✓

#### 5. PUNËT E ARMATURËS DHE KONSTRUKSIONIT METALLIK

Poz.5	Përshkrimi   pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
-------	------------------------	--------	-------	-------	-------



5.1	Furnizimi me material, prerja dhe lakimi i armaturave S-500, sipas detajeve te armimit si dhe armaturave rreze te parapara me projekt.	kg	24,509.28	0.85	€	20,832.89	✓	
5.2	Furnizimi me material si dhe montimi i konstruksionit te celikut (profilat e certifikuar) tek palestra sportive, te punohet sipas projektit, te behet edhe ngjyrosja adekuate (nje baze dhe dy shtresa ngjyre)	kg	17,842.00	1.20	€	21,410.40	✓	
						€	42,243.29	✓

#### 6. PUNËT E HIDROIZOLIMIT

Poz.6	Përsëkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma			
	KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR PUNËT E HIDROIZOLIMIT Punët e hidroizolimit në përgjithësi duhet të kryhen sipas projektit, Normave dhe Standardeve në fuqi. -Materjali që përdoret për punët e izolimit duhet të jetë i alestuar. -Baza në të cilën vendoset izolimi më parë duhet të jetë i lerur, dhe i pastruar nga pluhuri dhe yndyra. -Materjali i paraparë për izolim mund të zevendsohet me ndonjë material tjetër në rast se ekziston ndonjë material me cilësi më të mira.							
6.1	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i dyshemese dhe mureve te themeleve me një lyerje të ftohtë (bitulit) dhe dy shtresa të kondorit me l=4mm dhe shtresen e folise PVC(fundoline) mbl. Ngjitja bëhet me flakë dhe kalimi i shtresave është 15cm.	m <sup>2</sup>	850.00	4.00	€	3,400.00	✓	
6.2	Furnizimi me material si dhe vendosja e hidroizolimit te ftohte, dyshetresor, tek nyjet sanitare dhe ne vendet tjera ku ka lageshi , ne lartesi h=1.50m' .	m <sup>2</sup>	100.00	3.00	€	300.00	✓	
						€	3,700.00	✓



#### 7. PUNËT E MURATIMIT

Poz.7	Përsëkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma			
7.1	Furnizimi me material si dhe muratimi i mureve ne te gjitha nivelet nga blloqet e argjilos "Giler", me trashesi 10cm; 12cm; 15cm; 20cm dhe 25cm. Muratimi te punohet sipas standardeve ndertimore duke perfshi llaqin lidhes; trajet shtanguese nga betoni i armuar etj.	m <sup>3</sup>	271.50	57.00	€	15,475.50	✓	
7.2	Furnizimi me material si dhe punimi i mureve me pllaka knaufi kunder lagoshise (dy shtresor) tek pozicionet e parapara ne projekt, duke perfshi edhe konstruksionin metalik si dhe termoizolimimin lesh guri 8cm.	m <sup>2</sup>	18.46	45.00	€	830.70	✓	
7.3	Furnizimi me material si dhe montimi i ndarjeve te lualeteve me panele nga materiali "kampakt laminat" 12mm antibakterial sikurse edhe dyert, aksesoret tjere (kembizat, dorezat etj) te jene nga materiali jodorodiv inox, H=220cm, te ngrilen nga dyshemeja ~15cm.	m <sup>2</sup>	24.50	5.00	€	122.50	✓	
						€	16,428.70	✓

#### 8. PUNËT E NIVELIZIMIT

Poz.8	Përsëkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma			
8.1	Furnizimi me material dhe shtruarja e shtresës rrafshuese estrih: përzierje 1:3 çimentos/rërë duke përdorur rërën e lumit, trashësia e shtresës rrafshuese shkon 5-10 cm, te jete i armuar.	m <sup>2</sup>	668.00	6.00	€	4,008.00	✓	
8.2	Furnizimi me material dhe vendosja e termoizolimimit shtrudur - 5cm dhe folia PVC.	m <sup>2</sup>	668.00	2.00	€	1,336.00	✓	
						€	5,344.00	✓

#### 9. PUNËT E DYSHEMESË

Roz.9	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
9.1	Furnizimi me material si dhe vendosja e pllakave keramike te klasit te pare ne dyshemet e objektit te parapara sipas projektit me dim. 33x33x1.0cm.	m <sup>2</sup>	136.00	16.00	€ 2,176.00
9.2	Furnizimi me material si dhe vendosja e pllakave keramike t=1.0cm ne perimete te kthinave me lartesi 8cm.	m'	95.50	5.00	€ 477.50
9.3	Furnizimi me material si dhe vendosja e granilit natyral t=3cm shkeleset dhe t=2cm balloret ne hyrjet e objektit (to jene materiale adekuate per hapësira te jashtme), shkallet e jashtme dhe te brendshme etj.	m <sup>2</sup>	20.50	20.00	€ 410.00
9.4	Furnizimi me material si dhe vendosja e granilit natyral t=2.0cm ne perimeter me lartesi 8cm.	m'	10.50	5.00	€ 52.50
9.5	Furnizimi me material si dhe montimi: Dyshemeja ne sallën e sportit do te punohet nga Vinyli heterogjen si shtrese finale nga prodhuesi Tarkett apo ngjashem, me karakteristika te njejta. Pas shtresave te Plakes se betonit, shtreses hidroizoluese, termoizolimi, nivelizimi, vjen si shtrese perfundimtare shtresa e Vinyl heterogjen, me karakteristika te prodhuesit Tarkett apo ngjashem me pershkrime si me poshle: Trashesia totale 8.3 mm., pesha totale 6.035 kg/m <sup>2</sup> , Gjeresia 2m., Gjatesia 20.5/231m, aftesia thithese 33%, deformimi vertikal 1.2mm.-1.3mm., levizja vertikale e topit 100% - 99% - 98%, reagimi ndaj zjarrit Cfl si, rezistenca e qendrueshmerise ≤1g, rezistenca nga gjuermel 0.29 mm/-0.39mm≤0.50mm., rezistenca nga ngarkesa 0.10mm/-0.30mm, reflektimi i zerit 20dB, zhurmat e brendshme Klasa A ≤ 65 dB, Rezistenca termike 0.12 m <sup>2</sup> K/W, Ngjyra light green 26506 001-26507 001. Punimi i vijave te lojeve sipas projektit dhe standardeve.	m <sup>2</sup>	500.00	38.00	€ 19,000.00
9.6	Furnizimi me material si dhe montimi i llajseve nga materiali i njejt (te rekomanduara nga prodhuesi i dyshemese - Tarkett) ne perimeter te kthinave. Salla Sportive	m'	92.00	4.50	€ 414.00
					€ 22,530.00

10. PUNËT E KERAMIKËS					
Roz.10	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
10.1	Furnizimi me material si dhe vendosja e pllakave te keramikës ne muret e kthinave te parapara me projekt, te jene te klasit te pare. Aprovimin e mostres e bene organi mbikeqyres. Verejtje: Pllakat keramike vendosen deri ne lartesi te lavanit dhe velem ne kthinat hidrosanitare(WC+Dusha).Ne kthinat tjera si koridore, garderoba, kthina per rekuiza, vendoset velem shiriti prej 8 cm ne perimeter te mureve.	m <sup>2</sup>	243.20	16.00	€ 3,891.20
					€ 3,891.20

11. PUNËT E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES					
Roz.11	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
11.1	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve dhe pllaloneve të mbrendshme ne te gjitha nivelet me suva te gateshme pershire dhe shiritat BA ne sallën e sportit, te punohet sipas standardeve duke perdore shtresat e nevojshme, te perdoret rrjete gjate suvatimit si dhe kendet adekuate.	m <sup>2</sup>	885.50	6.00	€ 5,313.00

